



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.248/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit VAKAT, me seli Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), në Prizren, për shkak të mbulimit të posterit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr 248/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga Koalicioni Vakati

### A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni VAKAT-Prizren, të dorëzuar nëpërmjet postes me datën 05.06.2017 me të cilën pretendon se me datën në 04.06.2017, në orët e mbrëmjes, kanë dalë të vendosin posteret, në vendin e ashtuquajtur Ralin, në Prizren, dhe që në nesërmen me datë 05.06.2017, kanë vërejtur se posteret e tyre janë mbuluar me posteret e subjektit tjetër politik. Lidhur me ankesën parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si provë.

Në përgjigjen e subjektit politik NDS-së theksohet se aktivistet e tyre i kanë marr posterat dhe i kanë vendosur në shtyllë dhe për shkak mungesës së hapësirës, ku shihet qartë se kishte edhe shumë postera të tjerë, ka ardhur deri tek mbulimi i posterave, e jo me qëllim që të dëmtohet posterit i partisë tjetër.

Lidhur me këto pretendime, përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur një fotografi si prove.

NDS i hedh poshtë të gjitha akuzat e Dzezair Muratit si te pabazuara, dhe kërkojnë nga PZAP që ti refuzojnë të gjitha pretendimet ankimore.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar:**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë për tu bindur dhe për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te

provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të identifikuar në mënyrë bindëse dhe të qartë se është kryer shkelja e pretenduar në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nën 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 248/2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*

*së.*